

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Emine Kaçiku,, anëtare, në çështjen juridike të paditësve N. H., A. H., M. A., R. H., dhe N. H., të gjithë nga Komuna Podujevë, kundër të paditurës Kompania e sigurimeve “ Sigal” në Prishtinë, për shkak të dëmshpërblimit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.531/2013 datë 15.07.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 30 mars 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr. 531/2013 datë 15.07.2016 .

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr. 531/2013 datë 15.07.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Podujevë C.nr.298/2011 datë 07.11.2013, me të cilin në pjesën e parë të dispozitivit është miratuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve, dhe është detyruar e paditura që paditësve, secilit prej tyre, në emër të dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e nënës së tyre tani të ndjerës Z. H., të iu paguajë nga 5.000€, apo gjithsej shumën prej 25.000€, si dhe për shpenzime varrimi shumën prej 1.500€, dhe për ngritje të përmendores shumën prej 1.500€, të gjitha me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si për deponimet në kursim me afat prej një viti e pa destinim të përcaktuar duke filluar që nga data e dhënies së aktgjykimit të saj, data 07.11.2013 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 750€. Përtej pjesës së gjykuar, kërkesëpadia e paditësve është refuzuar si e pa bazuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet e lartpërmendura të ndryshohen ashtu që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK) shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se është jo kontestuese se më datën 08.05.2011 rreth orës 13,55, në rrugën lokale Podujevë-Kërrpimeh, në fshatin Peran në Podujevë, është shkaktuar aksidenti i komunikacionit në mes të automjetit të markës “Audi 89” me targa 01-139 BK, ngjyrë e kuqe, të cilën e ka drejtuar V. (A.) H., e në të cilin automjet si bashkë udhëtare ka qenë bashkëshortja e tij tani e ndjera Z. H., dhe automjetit tjetër të markës “Volkswagen 1 J Golf TDI ngjyrë hiri me targa 614-KS-086 i cili ka qarkulluar nga drejtimi i kundërt. Nuk është kontestuese se automjeti në të cilin e ndjera Z. H., ishte si bashkë udhëtare ishte i siguruar tek e paditura. Po ashtu nuk ishte kontestuese se gjerë tek aksidenti kishte ardhur kur drejtuesi i automjetit të markës “Audi 89” me të arritur në fshatin Peran, merr veprim kthimi në të majtë për tu kyqur nga rruga kryesore, dhe fillon të kthehet në të majtë, mirëpo me atë rast menjëherë goditet nga vetura tjetër e markës “Volkswagen 1 J Golf TDI” e cila ka qenë duke lëvizur në anën e vet të rrugës në drejtim të kundërtë. E ndjera Z. H., nga lëndimet e marra në këtë aksident ma vonë vdes. Pas vdekjes ajo kishte lënë fëmijët – këtu paditësit N. H., i lindur më 22.07.1968, A. H., më 15.05.1957, M. A, më 28.03.1963, R. H., 22.02.1976, dhe N. H., më 10.10.1970.

Në këtë gjendje faktike të vërtetuar kësi soji, gjykata e shkallës së parë pasi që ka gjetur se baza ligjore e kërkesëpadiës është vërtetuar, duke zbatuar kriteret ligjore për caktimin e një dëmshpërblimi të tillë, paditësve iu ka gjykuar në emër të vdekjes së nënës së tyre në aksident komunikacioni nga 5.000€, dhe për shpenzime varrimi 1.500€ si dhe për ngritje të përmendores 1.500€.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, pranon në tërësi si të bazuar një qëndrim të tillë të gjykatave të instancës më të ulët lidhur me pranimin e kërkesëpadisë së paditësve, pasi që aktgjykimet e goditura në këtë pjesë nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për të cilat kjo Gjykatë në kuptim të nenit 215 të LPK kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me shkelje tjera thelbësore të dispozitave në të cilat e paditura thirret në revizion.

Në revizionin e të paditurës thuhet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182.1 lidhur me nenin 406.1 dhe 420.1 të LPK, kjo nga se pa u mbajtur fare seanca përgatitore, gjykata është lëshuar drejtpërdrejtë në seancën e shqyrtimit kryesor. Këto pretendime të revizionit, Gjykata Supreme i refuzoi si të pa bazuara nga se në kuptim të nenit 401 të LPK, seanca përgatitore nuk është e domosdoshme kur gjykata konstaton se ndërmjet palëve nuk ka fakte kontestuese (neni 403) apo kur, nga shkak i pa ndërlkueshmërisë së kontestit, vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgatitore. Andaj në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë, për shkak të jo ndërlkueshmërisë së kontestit, me të drejtë, menjëherë është lëshuar në seancën kryesore pa mbajtur paraprakisht seancë përgatitore.

Sipas revizionit, në kuptim të nenit 1.7.2 të Kushteve të Standardit Minimal për Polisë të Sigurimit, që implementojnë Direktivën Administrative nr.1999/3 mbi Autopërgjegjësinë për automjetet e siguruara ndaj palës së tretë, është përjashtuar çdo përgjegjësi e kompanisë së sigurimit për dëmin e shkaktuar nga automjeti i cili drejtohet nga personi që nuk ka patent shofer. Dëmi është shkaktuar me fajin e V. H., i cili pa patent shofer ka drejtuar automjetin në të cilin ka qenë bashkëudhëtare e ndjera Z. H., Po ashtu në revizion thuhet se lidhur me fajësinë e drejtuesit të këtij automjeti nuk është kryer ekspertizë e komunikacionit, e as që ekziston aktgjykim penal i formës së prerë.

Pretendimet e lartë përmendura të paditurës, Gjykata Supreme e Kosovës, i refuzoi si të pa bazuara nga se Sipas nenit 3.1 të Rregullit 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë, në fuqi që nga data 25 shtator 2008 (në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit konkret), palët e treta të dëmtuara kanë të drejtë të ia paraqesin kërkesën për zhdëmtim drejtpërdrejtë kompanisë së sigurimit. Nëse i dëmtuari ia parashtron kërkesën për zhdëmtim kompanisë së sigurimit, siguruari si përgjigje për një kërkesë të tillë nuk mund të bëjë

kundërshtimet , që do të mund ti bënte ndaj të siguarit në bazë të ligjit, kontratës dhe kushteve të polisës së sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive e që i referohen shkeljes dhe mos përmbushjes së detyrimeve sipas ligjit apo kontratës që kanë për pasojë humbjen e mbulesës siguroese. Andaj në kuptim të kësaj dispozite ligjore, paditësit kanë të drejtë që nga e paditura të kërkojnë kompensimin e dëmit për dhimbje shpirtërore të shkaktuara me vdekjen e nënës së tyre të ndjerë, si bashkëudhëtare në automjetin e siguar tek e paditura, nga se e ndjera në këtë rast paraqitet si person i tretë i dëmtuar. Edhe vet e paditura nuk konteston se aksidenti ka ndodhur me fajin e drejtuesit të automjetit të siguar tek e paditura, kështu që edhe për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë me të drejtë rreth bazës juridike të përgjegjësive së të paditurës për dëmshpërblim në raport me paditësit, nuk ka nxjerrë prova tjera përveç atyre në shkresa të lëndës.

Po ashtu u vlerësuan edhe pretendimet e përgjithësuara të paditurës siç thuhet në revizionin, se lartësia e gjykuar në emër të dëmshpërblimit është e lartë dhe në kundërshtim me kriteret e kompanive të sigurimit dhe me praktikën gjyqësore. Pretendimet e tilla të revizionit përkitazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, Gjykata Supreme i vlerësoi si të pabazuara, jo vetëm se në mënyrë konkrete nuk janë sqaruar arsyet pse është i lartë dëmshpërblimi i gjykuar, por edhe se me rastin e gjykimit të lartësive të lartë përmendura në emër të dëmshpërblimit kontestues, në mënyrë të drejtë është zbatuar dispozita e nenit 201 i LMD. Me rastin e gjykimit të lartësisë së këtij kompensimi gjykata në kuptim të nenit 200 par.2 të LMD, duhet të kujdeset lidhur me rëndësinë e së mirës së cenuar dhe për qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, por edhe lidhur me atë që mos të favorizohen tendencat e palës tjetër të cilat nuk janë në lidhmëni me natyrën dhe qëllimin shoqëror të tij. Andaj, duke marrë parasysh kriteret e parapara në këtë dispozitë juridike si dhe shkallën e zhvillimit ekonomik të Kosovës, dhe standardin jetësor të qytetarëve në Kosovë, shumat e gjykuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë reale, dhe jo në kundërshtim me kriteret e lartpërmendura. Lartësia e dëmshpërblimit të gjykuar nuk është në kundërshtim me synimet shoqërore për të cilat është paraparë një formë e dëmshpërblimit të tillë , kështu që, për nga lartësia një dëmshpërblim i tillë, nuk është në kundërshtim as me kriteret e kompanive të sigurimit për zhdëmtimet në procedurë jashtë gjyqësore të personave të cilët në aksident komunikacioni, kanë humbur anëtarin e ngushtë të familjes , e as me praktikën gjyqësore të gjerë tanishme, andaj një lartësi e tillë e

dëmshpërblimit nuk paraqet qëllime fitimprurëse për paditësit, kështu që caktimi i kësaj lartësie të dëmshpërblimit nuk përfshihet me pa ligjshmëri të caktuar.

Për arsyet e dhëna më lartë revizioni i të paditurës u refuzua si i pa bazuar, andaj me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.33/2017, datë 30 mars 2017

Kryetari i kolegjit

Shukri Sylejmani